REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY
Njesia Org. / Org. Jedin / Org. Unit: 01
Nr.Prot. / Br.Prot / Prot.Nr: 01-030/01-0002627/24
Nr. i faqeve / Br. strana / No.pages: 1
Data / Datum / Date: 04/03/2024

# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

## Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica - Municipality of Mitrovica North

**Kryetari i Komunës**
**Nr.______________. Data: 04.03.2024.**
**Mitrovicë Veriore.**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, Ligjin Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

**V E N D I M**
**(Për Formimin e Komisionit për Raportim të Performancës Komunale)**

1. **FORMOHET** Komisioni për Raportim të Performancës Komunale, me këtë përbërje:

   1.1 Teuta Kastrati – Koordinatore (Zyrtare për Barazi Gjinore);
   1.2 Elbrus Sejdiu – Anëtar (Zyrtar në DKRS);
   1.3 Irfan Sinani – Anëtar (Zyrtar në DBF);
   1.4 Merita Jashanica – Anëtare (Zyrtare në DSHP);
   1.5 Binasa Syla Mikullovci – Anëtare (Zyrtare në DI)
   1.6 Asdren Peci – Anëtar (Zyrtar në DAP);
   1.7 Turkana Mripa – Anëtare (Zyrtare në DSHMS).

2. Anëtarët e Komisionit kanë për detyrë që të bëjnë Raportimin e Performancës në periudha vjetore secili për njësinë e vet përkatëse dhe të njëjtin t'ia dorëzojnë Koordinatorës së Komisionit.

3. Koordinatorja e komisionit obligohet që të përgatit Raport të përgjithshëm vjetorë për performancë komunale i cili duhet t'i dorëzohet Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, konkretisht Divizionit për Performancë Komunale.

4. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi, bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, Rregullorën Nr. 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit të Performancës Komunale, si dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Erden ATIQ**
______________________
**Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore**

**I dorëzohet:**
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 znj. Teuta Kastrati
1x1 Arkivit